



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Nacionalni Koordinator za Kulturu, Omladinu i Sport
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

Raport i shkurtër mbi tenderin e librave për nivelin komunal dhe çmimet tjera të nxënësve fitues në garat e Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik dhe Dituri në Republikën e Kosovës

Për herë të parë në Kosovë, në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për implementimin e Programit Nacional për Rininë në mënyrë institucionale janë organizuar gara për të gjithë nxënësit pa dallim. Të gjithë nxënësit fitues të garave janë shpërblyer dhe marrja e tyre është në proces.

Nga kjo garë e përgjithshme në nivelin shkollor, komunal dhe republikan të Garës Nacionale në Dituri si dhe Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik prej 316 mijë nxënësve sa ka gjithsej në Republika e Kosovës në nivelin fillor të mesëm të ulët dhe në nivelin e mesëm të lartë, janë shpallur 44,723 fitues nga 29 komuna pjesëmarrëse.

Në nivelin shkollor janë gjithsej 40,624 fitues. Të gjithë do të pajisen me certifikata nga qeveria e të cilat janë në përfundim të shtypjes.

Në nivel komunal vetëm në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik kemi 2078 fitues. Të gjithë fituesit do të pajisen me nga një set librash në vlerë prej 50 eurosh, të cilat do të jenë të mbështjella me paketim të veçantë.

Në nivel komunal për garën e Diturisë kemi gjithsej 1467 fitues. Të gjithë fituesit do të pajisen me nga një set librash në vlerë prej 50 eurosh.

Po ashtu, të gjithë nxënësit fitues të nivelit shkollor të Diturisë klasa e I-rë dhe e II-të do të pajisen me nga një set librash pasi që gara për ta mbaron në këtë nivel për shkak të natyrës së garës e cila e ka ruajtur karakterin thelbësor të lojës në formësimin e saj.

Të gjithë fituesit e garave të nivelit komunal do t'i marrin shpërblimet dhe çmimet nëpër shtatë rajonet e Kosovës, me atë rast do t'i marrin edhe certifikatat e vendeve të para që kanë zënë të gjithë nxënësit fitues. Në nivelin republikan të Garës Nacionale në Dituri ka pasur 131 fitues të bursave, vlera totale e së cilës do të ndahet është 35,980 euro.

Në po këtë garë, 215 nxënës fitues do të marrin pjesë në kampe kreative, shuma e së cilës është 64,500 euro.

Ndërkaq, për Garën Nacionale të Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik, 154 nxënës kanë fituar bursa vlera e përgjithshme e së cilës është 32,260 euro. Ndërkaq, janë 193 nxënës fitues të kampeve kreative që ka vlerën 57,900 euro.

Për informim korrekt të opinionit, ju njoftojmë se librat për të cilat është shpallur tenderi në vlerë prej 287,892 eurosh do t'u dhurohen 6,026 nxënësve fitues të garës së nivelit komunal në Garën Nacionale në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik si dhe Garës Nacionale në Dituri si dhe të gjithë nxënësve fitues të klasës së I-rë dhe të II-të në garën e Diturisë niveli shkollor.

Më poshtë po ju ofrojmë edhe pakot e librave që ndahen për nxënësit fitues të nivelit të komunal për Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik dhe për Dituri:



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport

Nacionalni Koordinator za Kulturu, Omladinu i Sport

National Coordinator for Culture, Youth and Sport



Lista e pakove me setin e librave për fituesit e garave nacionale për KKKM dhe për Dituri prej klasës së I-rë deri në klasën e XII-të.

	Klasa 1,2		
PAKO 1		TITULLI	AUTORI
		PRINCI I VOGEL	ANTONIE DE SAINT-EXUPERY
		PIPI CORAPGJATA	ASTRID LINDGREN
		BEMAT E LIZES NE BOTEN E ÇUDIRAVE	LUIS KEROLL
		AVENTURAT E PINOKUT	KARLO KOLODI
	Pako me dizajn per set		
	Klasa 3		
PAKO 2		TITULLI	AUTORI
		NJE FUNDJAVE E CMENDUR PER JERONIMIN	JERONIM STILTON
		LOJERA UDHETIMESH	JERONIM STILTON
		SYRI I UJKUT	DANIEL PENNAC
		JETA E NJE QENI	DANIEL PENNAC
		CFARE ZBULIMI	IRENE VENTURI
		HISTORIA E MIUSHIT DESPERADO	KATE DICAMILLO
		AKADEMIA E GJUEtareve TE DRAGONJVE-NXENESI I RI NE SHKOLLE	KEJT MEKMULLAN
		KONI,BILLI DHE BANDA E VAJZAVE	DAGMAR HOBFELD
		LUGJET E VERDHA 1	REXHEP HOXHA
		LUGJET E VERDHA 2	REXHEP HOXHA
		ISHULLI MISTERIOZ SHQIP - ANG	ZHYL VERN
	KRYEMINISTRI AKSIDENTAL	TOM McLAUGHLIN	
	Pako me dizajn per set		
	Klasa 4		
PAKO 3		TITULLI	AUTORI
		DITARI I GREGUT	JEFF KINNEY

	DITARI I GREGUT - RREGULLAT E RODRIGUT	JEFF KINNEY
	GJYSHI IM ISHTE NJE PEME QERSHIE	ANGELA NANETTI
	PRINCESHA ARGJIRO	ISMAIL KADARE
	OLIVER TUIST SHQIP - ANG	CARLS DIKENS
	NJEZETE MIJE LEGA NEN DET SHQIP - ANGLISHT	ZHYL VERN
	DJALI ME FUSTAN	DAVID WALLIAMS
	ME QUAJNE MBRETERESHA TEUTA	LUAN RAMA , SULID KASEMI
	DITARI I DJALOSHIT NERD	PHILIP OSBOURNE
	SHTEPIA MAGJIKE MBI PEME - KALORSI NE AGIM	MARY POPE OSBORNE
	ABSOLUTISHT FANTASTIK	LIZ PICHON

Pako me dizajn per set

Klasa 5

	TITULLI	AUTORI
PAKO 4	GJYSHJA GANGO	DAVID WALLIAMS
	ME QUAJNE ALBERT AINSHTAJN	LLUIS CUGOTA , GUSTAVO ROLDAN
	BOTA BRILANTE E TOM GEJTS	LIZ PICHON
	PETER PAN	XHEJMS METHJU BERRI
	VERORJA	REXHEP HOXHA
	ISHULLI I THESARTI SHQIP - ANG	ROBERT LUI STIVENSON
	HARRY POTTER DHE GURI FILOZOFAL	J.K ROWLING
	AVENTURAT E TOM SOJERIT SHQIP - ANG	MARK TUEIN
	AVENTURAT E SHERLOK HOLMSIT SHQIP - ANG	ARTUR KONAN DOJT
	PA SHQETESIME	LILY MURRAY
	UDHETIM NE QENDER TE TOKES SHQIP - ANG	ZHYL VERN

Pako me dizajn per set

Klasa 6

	TITULLI	AUTORI
PAKO 5	MREKULLIA	R.J. PALACIO
	TE MJERET	VIKTOR HYGO
	MATIA DHE GJYSHI	ROBERTO PIUMINI
	KUSH E SOLLI DORUNTINEN	ISMAIL KADARE
	HARRY POTTER DHE DHOMA E TE FSHEHTAVE	J.K ROWLING
	NJE JASHTETOKESOR NE FAMILJE	BIANCA PITZORNO
	ALBUM	FAN S. NOLI
	RREFIM MBI DY QYTETE	CHARLES DICKENS
	LULI I VOCERR	MIGJENI
	MERI YLL	VIKTOR CANOSINAJ

Pako me dizajn per set

Klasa 7

	TITULLI	AUTORI
PAKO 6	ME QUAJNE LEONARDO DA VINCI	ANTONIO TELLO
	XHA GORIOI	HONORE DE BALZAC
	DITARI I ANA FRANKUT	ANNE FRANK
	KESHTJELLA	ISMAIL KADARE
	MOBI DIK	HERMAN MELVILLE
	NITA	JOSIP V. RELA

PLAKU DHE DETI

ERNEST HEMINGWAY

		KENGET E MILOSAOS	JERONIM DE RADA
		HALLA E TMERRSHME	DAVID WALLIAMS
		ILIADA DHE ODISEJA	HOMERI
		HAJDI	JOHANNA SPYRI
		Pako me dizajn per set	
	Klasa 8		
PAKO 7		TITULLI	AUTORI
		QENDRO KU JE DHE PASTAJ NISU	JOHN BOYNE
		ZEMER	EDMONDO DE AMICIS
		DHEMBI I BARDHE	JACK LONDON
		ROMEO DHE ZHULIETA	SHEKSPIR
		CAJLD HAROLDI	BAJRON
		EDIPI MBRET	SOFOKLIU
		CA PIKA SHIU RANE MBI QELQ	ISMAIL KADARE
		AUTIKU DHE PELLUMBI	RODAAN AL GALIDI
		TE NUMEROSH YJET	LOIS LOWRY
	AVENTURA ILIRE	LLOYD ALEXANDER	
	Pako me dizajn per set		
	Klasa 9		
PAKO 8		TITULLI	AUTORI
		NATA E DYMBEDHJETE	SHEKSPIR
		TE HUAJT	S.E HINTON
		PERSE ME QUAJNE XHOVANI	LUIGI GARLANDO
		TE GJALLET DHE TE VDEKURIT E NJE FEMIJERIE	ARIF DEMOLLI
		GJENERALI I USHTRISE SE VDEKUR	ISMAIL KADARE
		E PENGUARA	ISMAIL KADARE
		I HUMBURI	FATOS KONGOLI
		TESI I D'ERBERVILEVE	THOMAS HARDY
	HAJDUTJA E LIBRAVE	MARKUS ZUSAK	
	Pako me dizajn per set		
	Klasa 10		
PAKO 9		TITULLI	AUTORI
		NE JEMI PAFUNDESI	STEPHEN CHBOSKY
		KATEDRALJA E PARISIT	VIKTOR HYGO
		MAMI	BRENDAN O'CARROLL
		TE PIKTUROSH TE ARDHMEN	LOUISE L. HAY & LYNN LAUBER
		ILIADA	HOMERI
		SHUME ZHURME PER ASGJE	SHEKSPIR
		EPI I GILGAMESHIT	Perkth. ANTON NIKE BERISHA
		DITARI I NJE VAJZE	ANONIME NGA VJENA
	ALKIMISTI	PAULO COELHO	
	Pako me dizajn per set		
	Klasa 11		
PAKO 10		TITULLI	AUTORI
		VAJZA E PORTOKALLEVE	JOSTEIN GAARDER
		NE TE TRE	FATOS KONGOLI
		DON KISHOTI I MANCES 1	SERVANTES
		DON KISHOTI I MANCES 2	SERVANTES
	DJELLA	MARTIN CAMAJ	

	TARTUFI	MOLIER
	EVGJENI GRANDE	HONORE DE BALZAK
	TE KESH DHE TE MOS KESH	ERNEST HEMINGWAY
	SHTEPI KUKULLE	HENRIK IBSEN
	Pako me dizajn per set	
Klasa 12		
PAKO 11	TITULLI	AUTORI
	BOTA E SOFIS	J.GARDER
	ZONJA BOVARI	GUSTAV FLOBER
	MIZANTROPI	MOLIER
	HAXHI MURATI	TOLSTOI
	ANA KARENINA 1	LEO TOLSTOY
	ANA KARENINA 2	LEO TOLSTOY
	NJERIU KAFKA	FRANC KAFKA
	PSIKOLOGJIA DHE BESIMI	KARL GUSTAF JUNG
	JESMINË	MARTIN CAMAJ
Pako me dizajn per set		

Për më shumë, Programi Nacional për Rininë është program i përhershëm që synon të plotësojë boshllëkun e aktiviteteve jashtë dhe brenda kurrikulare si dhe është plotësim i nenit 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për të drejtën e nxënësve në arsim, rrjedhimisht për mundësinë që duhet ta ketë çdo nxënës në aktivitete të tilla.